

“A e dini se cilat janë të drejtat tuaja?”

ÇFARË ËSHTË SHËNDETI DHE SIGURIA NË PUNË?

Ligji për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë (OHSA) i Ontarios u jep të drejta punëtorëve. Ai përcakton rolet për punëdhënësit, mbikëqyrësit dhe punëtorët në mënyrë që **VENDET E PUNËS TË JENË TË SIGURTA**.

KUSH MBULOHEK Nga OHSA?

POTHUAJSE TË GJITHË ata që punojnë në Ontario, qofshin sindikalistë apo jo, mbulohen nga OHSA.

PËRGJEGJËSIA E PUNËDHËNËSIT

Punëdhënësit duhet të marrin çdo masë paraprake të arsyeshme për të **MBROJTUR PUNËTORËT**.—OHSA 25(2)(h)

TË DREJTAT E PUNËTORIT

- Ju keni **TË DREJTË TË DINI** për çdo rrezik në punë ndaj të cilit mund të ekspozoheni.
- Ju keni **TË DREJTËN PËR TË MARRË PJESË** në procesin e identifikimit dhe zgjidhjes së shqetësimeve për shëndetin dhe sigurinë.
- Ju keni **TË DREJTË TË REFUZONI** të bëni punën që mendoni se është e pasigurt.

Është **E PALIGJSHME QË PUNËDHËNËSIN JUAJ T'JU PENALIZOJË** ose kërcënojë se do t'ju penalizojë për ushtrimin e këtyre të drejtave ose pyetjet rreth tyre.

PËRGJEGJËSITË E PUNËTORIT

Për të ndihmuar në ruajtjen e një vendi pune të sigurt dhe të shëndetshëm, ju gjithashtu keni detyra. Ju duhet:

- » NDIQNI LIGJIN**, politikat dhe procedurat e shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës.
- » VISHNI DHE PËRDORNI** pajisjet mbrojtëse të kërkuara nga punëdhënësi juaj.
- » PUNONI DHE VEPRONI** në një mënyrë që nuk do t'ju lëndojë juve dhe askënd tjetër.
- » RAPORTONI** çdo rrezik ose lëndim tek mbikëqyrësi juaj.



E DREJTA PËR TË DITUR

Ju keni të drejtë të merrni pjesë në **TRAJNIME** në mënyrë që të:



BËNI PUNËN TUAJ NË MËNYRË TË SIGURT



TË DINI ÇFARË TË BËNI NË RAST EMERGJENCE APO LËNDIMI

Së bashku me **OHSA**, ka rregulla që kërkojnë nga punëdhënësi juaj të sigurojë që ju të jeni të trajnuar dhe të informuar siç duhet për të bërë punën tuaj. Për shembull:

- » Punëdhënësi juaj duhet të sigurojë që ju të merrni informacione bazë me anë të TRAJNIMIT TË NDËRGJEGJËSIMIT PËR SHËNDETIN DHE SIGURINË.**
- » Nëse punoni me KIMIKATE TË RREZIKSHME** ose substanca të tjera të rrezikshme, ju keni të drejtë të trajnoheni se si t'i përdorni dhe trajtoni substancat në mënyrë të sigurt dhe të dini se cilat janë efektet shëndetësore nga ekspozimi ndaj tyre.
- » Ka shumë rreziqe të tjera për të cilat keni TË DREJTË TË TRAJNOHENI** nëse jeni ose mund të jeni të ekspozuar ndaj tyre.

Ju keni të drejtë të **INFORMOHENI** për shumë lloje rreziqesh që mund të ekzistojnë në vendin tuaj të punës, duke përfshirë rreziqet në lidhje me:



MAKINERITË DHE PAJISJET



KUSHTET E PUNËS



DHUNËN DHE NGACIMET NË PUNË

OHSA kërkon që punëdhënësi juaj të bëjë **GJITHÇKA TË ARSYESHME** për t'ju mbrojtur nga lëndimi ose marrja e një sëmundjeje të lidhur me punën.

E DREJTA E PJESËMARRJES

OHSA ju jep të drejtën për të marrë pjesë dhe për t'u përfshirë në ndihmën për të bërë dhe mbajtur vendin tuaj të punës të sigurt dhe të shëndetshëm. Në bazë të numrit të punëtorëve të punësuar, vendet e punës duhet të kenë një:

JHSC

KOMITETI I PËRBASHKËT PËR SHËNDETËSIN DHE SIGURINË me gjysmën e komitetit të përbërë nga punëtorë.

HSR

PËRFAQËSUESI I SHËNDETIT DHE SIGURISË i cili duhet të jetë një nga punëtorët.

20+ PUNËTORË

- » BËNI PYETJE** kur nuk jeni të sigurt për diçka.
- » Çdo punëtor ka të drejtën dhe përgjegjësinë që TË RAPORTOJË ÇDO RREZIK** në punë tek mbikëqyrësit e tij.
- » Ju mund të ndihmoni HSR-në tuaj ose anëtarin e JHSC DUKE VËNË NË DUKJE** rreziqet e mundshme në vendin tuaj të punës.
- » Ju mund të DILNI VULLNETAR** ose **TË EMËROHENI** nga sindikata juaj për të qenë një HSR ose një anëtar punëtor i JHSC.

6–19 PUNËTORË

A E DINIT?!

28 PRILLI është **Dita Kombëtare Zyrtare e Zisë** në Kanada për punëtorët e vrarë dhe të plagosur në punë. E vëzhguar nga sindikatat kanadeze që nga viti 1984, ajo u shpall zyrtarisht nga Qeveria e Kanadasë në vitin 1991 dhe që atëherë është përhapur në më shumë se 100 vende. Punëtorët, familjet e tyre dhe sindikatat e tyre mblidhen më 28 Prill për të nderuar punëtorët e vrarë dhe të plagosur në punë në të gjithë Kanadanë dhe botën, duke vendosur shpesh kurora me lule në monumentet lokale për nder të tyre.

PËRMIRËSIMI I SHËNDETTIT DHE SIGURISË NË VENDIN TUAJ TË PUNËS

Mësoni për JHSC ose HSR tuaj. Bisedoni me ta dhe me kolegët tuaj për shqetësimet e shëndetit dhe sigurisë. Nëse punëdhënësi juaj nuk i adreson shqetësimet, ju mund të ushtroni të drejtën tuaj për të refuzuar punën nëse besoni se nuk është e sigurt. Ju gjithashtu mund të kontaktoni Ministrinë e Punës në **1-877-202-0008** ose të gjeni më shumë informacion në www.labour.gov.on.ca

PUNËNËDHËNËSI JU DËNON APO KËRCËNON?

Nëse mendoni se punëdhënësi juaj po merr masa kundër jush për shkak të ngritjes së shqetësimeve për shëndetin dhe sigurinë ose për ushtrimin e të drejtave tuaja për shëndetin dhe sigurinë, mund të kontaktoni Ministrinë e Punës ose sindikatat, nëse keni një të tillë.

Nëse nuk i përkisni një sindikate, mund të kërkonti ndihmë falas nga **ZYRA E KËSHILLARIT TË PUNËTORËVE (1-855-659-7744)** ose **ZYRA LIGJORE E SHËNDETËSISË DHE SIGURISË SË PUNËTORËVE (1-877-832-6090)**. **TI NUK JE VETËM!**

E DREJTA PËR REFUZIMIN E PUNËS SË PASIGURTË

Ju keni të drejtë të refuzoni punën e pasigurt kur keni **ARSYE TË BESONI** se:

- » Puna që po bëni ose PAJISJET APO MAKINERIA që po përdorni mund t'ju lëndojë ju ose dikë me të cilin punoni ose gjendja fizike e vendit të punës është e rrezikshme; ose**
- » Ju gjithashtu keni të drejtë të refuzoni punën nëse jeni në rrezik nga DHUNA NË VENDIN E PUNËS.**

SI TË REFUZONI PUNËN E PASIGURTË

01

Për refuzimin e punës së pasigurt, **DUHET T'IA THONI MENJËHERË PUNËDHËNËDHEËSIT APO MBIKËQYRËSIT TUAJ.**

02

Punëdhënësit tuaj **I KËRKOHEK** **LIGËRISHT TË HETOJË** me një anëtar punëtor të JHSC ose HSR.

03

Ju duhet të qëndroni në një **VEND TË SIGUR, PRANË STACIONIT TË PUNËS**, derisa të përfundojë hetimi.

04

Nëse keni **ARSYE** për të menduar se puna juaj është ende e rrezikshme pas hetimit të punëdhënësit, punëdhënësi duhet të thërrasë një **INSPEKTOR TË MINISTRISË SË PUNËS** për të hetuar.



ÇFARË TË BËJ NËSE JAM TË LËNDUAR NË PUNË?

Nëse lëndoheni në punë ose keni një sëmundje për shkak të ekspozimit ndaj kimikateve toksike, duhet:

KËRKONI KUJDESIN MJEKËSOR (ndihma e parë dhe/ose kujdesi shëndetësor).

FLISNI ME PUNËDHËNËSIN sa më shpejt të jetë e mundur.

MBANI REGJISTRIMIN e detajeve të lidhura me incidentit/dëmtimin.

